

CAT MAGAZINE

NUMRI 3 2013 WWW.CAT.COM

KATËR VITE DUKE U BËRË

NUMRI I PARË CAT® HIBRIDI
336E KA MBËRRITUR

KLIENTËT SHPREHIN MENDIMET E
TYRE

**CAT® 740B DHE
NXJERRËSI 740B**

BEIRUTI I BUKUR

SI PO E MBAN QYTETIN E PASTËR
AVERDA



Teknoxgroup



SHPALOSNI JETËN E DYTË TË MOTORIT TUAJ CAT

Nëse kantieri juaj është në mes të një shkretëtire apo pranë një qendre urbane, rindërtimi i një motori mund të jetë një punë e vështirë. Një motor diesel përmban qindra pjesë, secila me numra specifike pjesësh. Identifikimi i këtyre numrave, sasive të pjesëve dhe porositja e të gjithë pjesëve të veçanta zëvendësuese mund të jetë një proces që konsumon kohën. Zgjidhja janë Kompletet e Metaleve të Çmuara Cat.

KOMPLETE ME KOSTO EFEKTIVE ME PJESË TË VËRTETA CAT

Motori i makinës suaj Cat ndërtohet për një jetë të dytë, madje të tretë. Tani është më lehtë sesa kurrë më parë për t'i dhënë jetë të tjera me anë të kompletit tonë të rindërtimit të motorit. Pjesët që ju nevojiten për të rindërtuar motorin tuaj siç duhet disponohen në një komplet të lehtë për tu porositur, dhe me kosto efektive që ju kthen në punë shumë shpejt. Me performancën shumë të mirë dhe jetën e gjatë që pjesët e vërteta Cat mund të japin. Katër nivele të ndryshme të completeve janë të disponueshme. Cilindo opsion që zgjidhni – Bronz, Argjend, Ar ose Platin – secili komplet në vetvete dhe në kombinim me pjesët e lidhura përfshijnë komponentët e kërkuar për të plotësuar një riparim të përgjithshëm, për nevojat tuaja specifike. Ju kurseni kohë dhe para dhe fitoni njohuri shtesë. Secili komplet mbështetet në një garanci Caterpillar – pavarësisht se kush e kryen punën.



Kompleti i ri i rindërtimit të motorit Cat 3406 që përdoret për një riparim të përgjithshëm të motorit në Poloni.

TRAKTORI CAT D8, I PËRDORUR PËR TË TESTUAR KOMPLETET E METALEVE TË ÇMUARA 3406, MERR NJË JETË TË RE PAS TRANSFERIMIT TË GURORES

Inxhinierët e Caterpillar i kanë zhvilluar këto komplete për të thjeshtuar rindërtimin e motorit tuaj. Për tu siguruar që ato të përmbajnë çdo gjë të nevojshme për riparimin e përgjithshëm të një modeli motori specifik, Caterpillar i piloton kompletet në terren.

Për shembull, një komplet Metalesh të Çmuara Cat 3406 i sapo projektuar kohët e fundit shkoi tek një klient në Poloni. Nuk është vetëm një riparim i përgjithshëm motori i thjeshtëzuar, ai e shpëtoi një traktor D8 të tipit me zinxhir që të mos përfundonte në pìrgun e skrapit. D8 ishte përfshirë në një aksident ndëshkues transferimi në një gurore Sllovaqe dhe ishte magazinuar jashtë, i paprekur, për disa vite. Motori kishte një bosht me gunga të përkulur dhe përmbante 60 litra ujë që kishte ndryshkur shumë prej komponentëve.

Lukasz Klukowski, i zyrës së rrethit Pragë të Caterpillar thotë: "klienti, Shvedurski i bleu pjesët që nuk ishin pjesë e kompletit të rindërtimit, si boshti me gunga. Megjithatë, kompleti përfshinte shumë më tepër sesa të gjithë pjesët e tjera që nevojiteshin. U organizua mirë dhe çdo gjë mbërriti para kohë, gjë që ishte një plus i madh." Dhe D8? "Ai ka praktikisht një motor tërësisht të ri, gati për një jetë tjetër." Shvedurski tani planifikon që ta përdorë D8 për të zgjeruar operacionin e tij. ■

Shih për më tepër në:
www.parts.cat.com/rebuildkits

JU MUND T'I LINI KOMPLETET E METALEVE TË ÇMUARA NË BANAK OSE NËPËRMJET SERVISIT NË ÇDO VENDNDODHJE TË TREGTARIT TË AUTORIZUAR CAT.

Platini është një opsion më i plotë i redaktimit të motorit i projektuar për të maksimalizuar jetën e ndërtuar të dytë ose të tretë të motorit tuaj dhe përfshin:

- Çdo gjë në Kompletin e Bronzit.
- Pjesët e cilindrit 6 Cat Reman të paramontuara për të kursyer orët e punës.
- Injektorët e 6 Cat Reman.
- Koka e plotë e cilindrit Cat Reman e paramontuar për të kursyer orët e punës.
- Pompat e karburantit dhe vajit të Cat Reman.
- Zgjidhni kompletin që është i mirë për ju bazuar në modelin e shitjeve të motorit dhe numrit serial.
- Komponentët shtesë mund të porositen siç nevojiten (referojuni listës së pjesëve që lidhen me to).



Përmbajtja



NË TERREN SUKSESI

04

BEIRUTI I BUKUR

Një shoqëri merret me çështjet e mbetjeve të qytetit

16

KLIENTËT E CATERPILLAR SHPREHIN MENDIMET E TYRE

Kamionët Cat 740B dhe Ejektori 740B kanë një gjë të përbashkët - rendimentin

NOVACIONET NË LËVIZJE

08

336E H – KATËR VITE DUKE U BËRË

Ekskavatori i parë hibrid Cat e çon ekonominë e karburantit në një nivel tjetër

15

TË MENDUARIT E TË GJITHA GJËRAVE E NDIHMON BARLOËORLD QË TË MENDOJË PËR NJË AFAT TË GJATË

Trajnimi i një klase të re teknikësh me aftësi të larta në Afrikën e Jugut

PËRPARA TË MENDUARIT

11

PRERJA E MBETJEVE NË APLIKIMET E MENAXHIMIT TË MBETJEVE

Një vështrim hap pas hapi se si të reduktohen kostot e operimit

14

FOKUSI

Fokusi në Qendrën e Vizitorëve të Caterpillar dhe kërkimin autonom të operacionit

I DASHUR LEXUES,

Nëse mund ta përmbledhja këtë numër këtë Revistës Cat në një fjalë, do të ishte pa precedent. Nga eksplorimet e Antarktikut deri në operimin autonom të makinës, i vetmi ekskavator hibrid i klasit të vet, historitë në faqet në vijim tregojnë gjëra të mrekullueshme.

Megjithatë, një histori e mrekullueshme që nuk përfshihet në këtë numër, por që ja vlen ende të përmendet, është sponsorizimi i Caterpillar për OCEARCH. OCEARCH është udhëheqësi botëror në kërkimin e peshkaqenëve, veçanërisht peshkaqenët e mëdhenj të bardhë. Metodrat e tyre novatore dhe përkushtimi kanë mbledhur informacion të ri për biologjinë, shëndetin dhe migrimin e peshkaqenëve. Bota ka filluar të kuptojë disa nga misteret kanë zgjatur në kohë të këtyre “luanëve të oqeanit”.

Gjetja e përgjigjeve për pyetjet e forta duke përdorur teknologjinë më të fundit është pikërisht lloji i sfidës pjesë e të cilës duam të jemi të kënaqur që t'i ndihmojmë ata që të bëjnë kërkimet e tyre të rëndësishme dhe studimet e qëndrueshmërisë të mundura. Dhe, jam krenar të them se pajisja Cat ndihmon që të lëvizin dhe të kenë fuqi anijet e ekipit 38-metra-të gjata.

Kam qenë me mjaft fat që tu hedh një sy të gjithë historive të këtij numri. Artikulli ynë i thelluar detajon se si pajisja Cat ndihmon ofruesin e zgjidhjeve më të mëdha mjedisore në Këshillin e Kooperimit të Gjirit, rajonet e Lindjes së Mesme dhe Afrikës së Veriut. Ne shikojmë se si 3775G po tregojnë vlerën e tyre në një gurorë kuarcitësh në Norvegjinë e largët veriore. Dhe shikojmë në brendësi Qendrën e re të Distribucionit të Lindjes së Mesme të Caterpillar.

Siç do të thoshin në Antarktikë kjo është vetëm maja e ajsgbergut. Shpresoj që ju të kënaqeni duke lexuar këtë numër të tretë të vitit 2013 po aq sa u kënaqa unë.

Nigel Lewis,

Zëvendës-president, Caterpillar



COLOPHON:

Më sipër është shija e asaj që ndodhet në këtë numër – do të gjeni shumë më tepër lajme dhe pikëpamje brenda. Nëse keni ndonjë ide për ndonjë histori për numrin e ardhshëm, kontaktoni botuesit tanë në CatMagazine@cat.com

Revista Cat shpërndahet nga tregtarët e Cat-it në Evropë, Afrikë, Lindjen e Mesme dhe CIS tre herë në vit. Ju lutemi dërgoni korrespondencën tuaj editoriale tek Revista Cat Caterpillar S.A.R.L. 76, Route de Frontenex, PO box 6000, 1211 Gjenevë 6, Zvicër. Catmagazine@cat.com. Të gjitha të drejtat e rezervuara. ©2013 Caterpillar.

BOTUESI: Gregory Maricou, Caterpillar S.A.R.L. **KRYEREDAKTORI:** Laetitia Baudrion, Caterpillar S.A.R.L. **KOORDINUESI I TREGTARIT:** Anneloes de Jong **SHKRUESI KRYESOR:** Trevor Baker **DREJTIMI I ARTIT:** Ron Strick, Karen Bouten **KONCEPTI & REALIZIMI:** Centigrade for Caterpillar S.A.R.L. www.centigrade.com **KONTAKTI I TREGTARIT VENDOR:** info@teknogroup.com

BEIRUTI I BUKUR

SIPO E MBAN QYTETIN E PASTER AVERDA



Bejruti, një qytet me rreth 2 milionë banorë në një vend me 4.4 milionë, ka pasur një problem kronik me mbeturinat. Në verën e vitit 1996, rrugët ishin të mbuluara me mbeturina shtëpiake dhe temperaturat në numrat e lartë të 30 gradëve prodhonin një erë të keqe që përkeqësohej nga mjegulla prej tymi që lëvizte ngadalë nga pirqjet e mëdhenj të plehrave që digjeshin pikërisht jashtë qytetit. Plasmasi, shishet, kanoçet dhe letrat të gjitha hidheshin së bashku dhe siç thotë Hani Wazzan, Drejtori i Zinxhirit të Furnizimit averda, “Qyteti po hidhte paret poshtë. Duke i djegur ato. Ata po harxhonin mbetjet e mira.”



Qeveria Libaneze paraqiti “Planin e Integruar të Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta”, dhe bëri një tender duke u kërkuar shoqërive që të mund të krijonin të menaxhonin dhe përfundimisht të mbushnin një landfill prej 400,000m² në rrethinat e qytetit.

Sot kamionët averda i ngjisin rrugët e vijuar me pemë që çojnë drejt Jugut të Bejrutit deri sa të arrijnë një luginë të fshehur. E ndërlidhur me sistemin e menaxhimit modern të gazit, ky është ndalimi i plotë në fund të historisë që tregohet çdo orë të çdo dite në rrugët e qytetit më poshtë. Një histori mbledhjeje dhe ndarjeje, riciklimi dhe rinovimi, historia e averdas dhe Cat® Tregtari Jallad i Libanit.

STACIONI I VEÇIMIT

Moustafa Al-Zoughbi është Inxhinier Mekanik në krye të fabrikës së veçimit të ngarkuesit 962H në Amroussieh. E

vënë në punë në Shkurt 2012, ajo punon 22 orë në ditë në një prej dy fabrikave të veçimit të averdas. Detyra e saj është të trajtojë plehrat e mbledhura nga banorët e Bejrutit, ku secili prej tyre gjeneron një mesatare prej 2kg në ditë. Natën dhe ditën, 350 kamionë të qytetit gjëmojnë përmes dyerve, boshatisin 6 tonët e tyre të ngarkesave me plehra, dhe zhduken përsëri në rrugët për të vazhduar mbledhjen e tyre.

962H ka shënuar 6,800 orë deri tani pa problem: “i vetmi problem që patëm ishte një pompë uji që pësoi defekt, e cila u rregullua në më pak se 4 orë, që është një provë e besueshmërisë që flet vetë” thotë Moustafai.

Problemi me plehrat nuk është era e keqe e tyre sepse averda ka një zgjidhje për kontrollin e plehrave. Problemi me plehrat është efekti i tyre tek gomat dhe tek dyshemeja operuese, duke e bërë atë një nga mjediset më gërryese me të cilët mund të operojë një mjet. “962H ka goma L5,” thotë Moustafai, “ato janë goma më e trashë e disponueshme, 44cm nga disku deri lart. Me një përdorim normal, gomat rrojnë me një mesatare prej një vit e gjysmë. Këto u montuan rreth 3 muaj më parë,” shpjegon ai duke treguar rrotat.

Gomat tani janë po aq të lëmuara sa diçka nga Formula Një. “Mbetjet dhe uji që rezulton nga mbetjet e ha gomën, duke i zhveshur gomat nga mbërthimi i tyre. Kjo i shtohet sfidave për operatorin, por diferenciali me rrëshqitje të kufizuar bën një dallim real për punën, vërtetë ndihmon.”

Diferenciali me rrëshqitje të kufizuar (LSD) është një specifikim i veçantë për makinat në aplikimet e dyshemesë/magazinimet. Ndërsa makina e shtyn materialin në grumbullim, aksi i parë bëhet i lehtë dhe mbështetet në aksin e pasmë për të transferuar shtytjen, duke reduktuar në këtë mënyrë dredhjen e panevojshme të rrotës që shkurton jetën e gomave.

Për Wael Ibrahim, Menaxheri i Llogarisë averda dhe Ghassan Dbouk, Menaxheri i Operacioneve të Shërbimit në Jallad, kushtet e zakonshme të ashpra të punës të fabrikës së veçimit janë një rast për të treguar fuqinë dhe besueshmërinë e ngarkuesve Cat.

“Unë harxhoj shumë kohë me klientët,” thotë Wael, “dhe përpara se të sillej 962H, kishte një problem me rrëshqitjen, me ngarkuesit që nuk merrnin tërheqjen në një dysheme rrëshqitëse. Ne montuam një diferencial me rrëshqitje të kufizuar tek 962H, dhe kam dëgjuar nga shumë njerëz për dallimin që ka bërë ai. Kjo është arsyeja përse vazhduam të ofrojmë ngarkuesin 950H me LSD si dhe shumë opsione të tjera të dobishme.”

Suksesi i 962H e bëri Jallad që të propozojë një ngarkues 950H me opsione të plota për një fabrikë tjetër veçuese në Karantina, i cili përveç diferencialit me rrëshqitje të

kufizuar, ju montua një kamera me pamje nga pas, lubrifikim auto, ventilatorë rikthyes dhe krahë për ngritje të lartë.

Tony Saade, Menaxheri i Fabrikës në Karantina, i përshkruan rezultatet: “Operatorët e çmojnë faktin që ata mund ta bëjnë detyrën e tyre pa u ndërprerë nga gomat. Dhe kamera me shikim pas u jep atyre disa sy të tjerë për të lundruar lehtësisht përmes pirgjeve të mbetjeve nga kamionët e mbeturinave në linjat e veçimit.”

KTHIMI MIKPRITËS I NJË KLIENTI

Tarek Jallad është Drejtori i Shitjeve dhe Marketingut të tregtarit Cat Jallad, dhe përkushtimi për klientin e tij është diçka që e ndan i gjithë ekipi i tij. “Rreth dhjetë vite më parë, averda zgjodhi që të bëhet ortak me një furnizues tjetër për pajisjen e tyre,” shpjegon ai, “dhe ky ishte një zhgënjim i madh”. Rindërtimi i marrëdhënieve ka dashur përpjekje substanciale, kohë dhe ndjekje të të gjithë niveleve në të dy organizatat.

Kur furnizon një klient me pajisje të besueshme, eficiente është vetëm fillimi: shitjet nuk janë fundi i historisë. Ne e dimë të gjithë se mbështetja e produktit është një prioritet real. Duke punuar përsëri me averda, kjo i mundësoi Jallad që të kalonte në një standard më të lartë të shërbimit të klientit.

Një nga veprimet e para që ne ndërmorëm ishte që t'i kërkonim Specialistit të Aplikimit të Mbetjeve të Caterpillar që të bashkohej me ne në një javë intensive takimesh me personelin kyç të averdas, në kantiere të ndryshme të shoqërisë, për të identifikuar qartësisht specifikimet më optimale që i nevojiteshin flotës. Në veçanti, qëllimi ynë ishte që tu jepnim

Besueshmëria dhe mbështetja guri i themelit të partneritetit të fortë.

sugjerimeve vlerë të shtuar si për ekipet e operacioneve dhe të mirëmbajtjes së averdas dhe të angazhoheshin si konsulentë të besuar. Prej atëherë e në vazhdim ne mundëm që të përmbushnim të gjithë kërkesat e averdas.

Së pari në vitin 2011, në flotën e fabrikës së veçimit të averdas u soll një ngarkues 962H që trajtonte mbetjet, së bashku me një ngarkues standard 950H për mbledhjet e mbetjeve të bashkisë. Atëherë në 2012, averda tregoi besimin në rritje të saj si për Jallad dhe për pajisjen Cat me një porosi për një 950H me ngritje të lartë, një trajtues mbetjes 950H, një buldozer landfilli D6R, një ngarkues me zinxhirë landfilli të Përdorur të Certifikuar 963, dhe dy ngarkues 216B3 rrëshqitës. Në vitin 2013 përsëri ne kemi marrë një porosi për një ngarkues tjetër 962H për landfillin. Shpresojmë që të vazhdojë rritja e këtij partneriteti në muajt dhe vitet që vijnë.”

“Këto makina punojnë 24 orë me 3 turne dhe servisi ju bëhet nga një ekip i përkushtuar teknik nga tregtari Cat Jallad,” thotë Ghassan Dbouk, Menaxheri i Operacioneve të Shërbimit. “Kur themi se ne jemi të disponueshëm për 24 orë, ne e kemi me gjithë mend. Në qoftë se vjen një thirrje, asaj i përgjigjemi dhe inxhinierët nisen.”

Me krahët e tij të lartë dhe kamerën për shikim pas, 950H është një pjesë jetësore e flotës averda në fabrikën Karantina.





1

RRITJE E JASHTËZAKONSHME NË NJË KLIMË TË PARREGULLUAR

Rajoni i Lindjes së Mesme/Afrikës Veriore (MENA) ka pak ose nuk ka rregullim kur vjen fjala për riciklimin. “Ne po vendosim standarde në këtë industri,” shpjegon Hani Wazzan, Drejtori i Zinxhirit të Furnizimit të averdas.

“Një sistem 24/7 (24 orë për 7 ditë të javës) i grumbullimit, veçimit, trajtimit, riciklimit dhe depozitimit është i mundshëm vetëm me përpjekje të kombinuara të punonjësve, furnizuesve dhe klientëve tanë. Dhe për shkak se nuk ka aktualisht një kulturë të riciklimit në Liban, ne kemi paraqitur një program të edukimit, mësimin të fëmijëve për rëndësinë e përdorimit të burimeve me kujdes. Filozofia e averdas është mbrojtja e planetit dhe ne besojmë se ai/ajo fillon me fëmijët të cilët do të rriten për të qenë vendimmarrës, të cilët një ditë do të përgjigjen për botën.”

Maysarah Sukkar themeloi averda në vitin 1965, si pjesë e Inxhinierimit Sukkar. Kur shoqëria njohu nevojën për menaxhimin eficient të mbetjeve dhe burimeve, averda menjëherë u specializua në këtë sektor, duke u rritur me shpejtësi duke u bërë ofruesi më i madh i zgjidhjeve mjedisore në Këshillin e Kooperimit të Gjirit (GCC) dhe rajonet MENA. Me më tepër se 7,500 punonjës, averda tani operon në të gjithë Libanin, Arabinë Saudite, Emiratet e Bashkuara Arabe, Oman, Katar, Irak, Mbretëria e Bashkuar, Francë, Irlandë dhe Marok. Kështu, pse ndodhi kthimi tek Caterpillar pas një mungese kaq të gjatë?

“Ne kemi një qytet të bukur që planifikojmë ta mbajmë të bukur dhe kjo do të thotë se na nevojitet besueshmëri dhe mbështetje,” thotë Z. Sukkar. “Historia nuk mbaron kurrë, kështu ne duhet të sigurohemi që të mos ndalojmë asnjëherë.” ■



2



3



4

1. Operatorët çojnë fuqinë dhe kontrollin e Cat® Ngarkuesit.
2. Hani Wazzan, Drejtori i Zinxhirit të Furnizimit, duke rritur standardet në të gjithë MENA.
3. Tarek Jallad, Drejtor i Shitjeve & Marketingut në tregtarin Cat Jallad.
4. Mohammad Akil, Menaxheri i Fabrikës mbikëqyr operacionet 24/7 në Amroussieh.

Shih për më tepër në: www.cat.com/waste/products-and-applications

KATËR VITE PËR TU BËRË

MAKINA CAT® E PARË E BËRË NDONJËHERË
HIBRIDI 336E KA MBËRRITUR



Cat® 336 është njohur për një kohë të gjatë në të gjithë botën si kali i punës me performancën më të madhe në aplikimet e prodhimit të lartë. Është makina “shko-tek” për operacionet intensive lëkundëse që shkojnë nga hapja e kanaleve deri tek ngarkimi i kamionëve. Tani me futjen e 336E H, niveli i pa krahasueshëm virtualisht i performancës vjen me një përfitim tjetër – ekonomia e karburantit udhëheqëse e industrisë, në saj të teknologjisë novatore hibride të Caterpillar.





E gjitha kjo përmblihet në një formulë të thjeshtë, dhe siç thotë Cédric Masson, Specialist i Aplikimit të Produktit për Ekskavatorët me Zinxhirë, "Sa më tepër lëvizni, aq më shumë efikasitet merrni nga makina." Ndërsa shumica e njerëzve e lidhin fjalën "hibrid" me një burim energjie elektrike, Cédric shton se, "Në fakt fjala hibrid realisht përkufizon sistemin e punës nga dy burime të ndryshme energjie që lidh, magazinon dhe ripërdor energjinë." Dhe është kjo formulë e thjeshtë që bëri që Cat 336E H të fitonte Çmimin e lakmuar Edison, i cili njeh novacionet dhe iniciativa që krijojnë një impakt pozitiv në botë. Duhet shënuar gjithashtu se përveç Çmimit Edison, 336E H i është dhënë gjithashtu një Çmim i Novacionit nga Revista Bota e Pajisjeve.

FUQIA E PATENTUAR, PERFORMANCA DHE RENDIMENTI

Kështu e kanë parë inxhinierët e Caterpillar. Rezultati është më pak kompleks, më pak i kushtueshëm dhe një sistem hidraulik hibrid shumë më efikas. Koncepti është i drejtpërdrejtë dhe përdor tre blloqe ndërtimi të teknologjisë:

- 1 një sistem lëvizës hibrid hidraulik
- 2 një pompë të Programueshme të Standardizuar Elektronike (ESP)
- 3 një valvul të Sistemit Kontrolli Përshtatës (ACS)

Pompa ESP kontrollohet në mënyrë elektronike. Detyra e saj është që të kryejë një tranzicion pa probleme midis burimeve me dy energji të ekskavatorit, motorit dhe akumulatorëve. Dhe ajo garanton të njëjtin rrjedhë hidraulike në shpejtësitë operuese të motorit më të ulët që do të thotë efikasitet më e mirë.

Nga ana tjetër, sistemi lëvizës hidraulik kap energjinë e frenit të lëvizjes. Për shembull, sa herë që operatori frenon nga fundi i ndërrimit, energjia kinetike ngarkon akumulatorët, të cilët pastaj e ripërdorin atë energji për ndërrimin në drejtimin e kundërt.

Guri i themelit që e solli gjithë këtë ishte zhvillimi i valvulës së re Cat ACS. "Ajo është praktikisht në qendër të konceptit të 336E H," thotë Cédric. "Valvula jonë e re ACS është truri





SA-Anlegg është blerësi i të parit hibrid 336E në të gjithë botën.
Ceremonia në Bauma me Inge Stensland, MD Pon Norvegji; Sten Antonsen, Pronari i SA Anlegg; Doug Oberhelman, Kryetari & Administratori i i Caterpillar; Per Gunnar Hanssen, Shitës, Pon Equipment Norvegji; Rob Charter, Divizioni i Ekskavatorëve të Caterpillar VP.



Takoni të vetmin ekskavator hibrid të klasit të tij.

që optimizon sistemin dhe realisht e bën të gjithë atë të konservojë, optimizojë, ripërdorë punën e konceptit.”

Sigurisht ndërsa koncepti është i drejtpërdrejtë zhvillimi i teknologjisë për të kontrolluar sistemin ishte një detyrë shumë më e komplikuar. Caterpillar depozitoi më tepër se 300 patenta për teknologjinë e përdorur në 336E H.

EKONOMIKISHT E ZGJUAR, EKOLOGJIKISHT KURSIMITARE
Hibridi i ri ka një prejardhje me një rendiment të lartë në klasin e peshës. Një makinë me 36- deri në 38-meter ton (në varësi të konfiguracionit), 336E H efektivisht nuk krahasohet me asnjë ne rendiment dhe eficiencë të karburantit. Është vërtet një

Caterpillar depozitoi më tepër se 300 patenta për teknologji të përdorur në 336E H.

peshë e rëndë idealisht e përshtatur për operacione intensive prodhimi të një shkalle të gjerë, punime gurorë, hapje kanalesh dhe detyra ngarkimi të kamioneve me volum të madh.

Në fakt 336E H jep të njëjtin rendiment me kosto shumë më të ulta të karburantit. Kjo vjen në saj të tri teknologjive (pompa ESP, valvola ACS dhe sistemi hibrid lëvizës) që punojnë në sinergji me njëri-tjetrin.

Parashikohet që shumica e adoptuesve të 336E H do të jenë klientë që zëvendësojnë makinat 336D L. “Thjesht duke lëvizur nga seria D në E, kjo ofroi eficiencë më të mirë karburanti, aftësi më të mëdha ngritëse, nevojë më të ulët për mirëmbajtje dhe një reduktim të zhurmës në 4 dB në kabinë, komfort i rritur i operatorit,” shtoi Cédric. “Duke filluar me të gjitha këto pluse, ne po reduktojmë konsumin e karburantit dhe gjurmën e karbonit akoma më shumë. Krahasuar me 336D L, 336E H i ri djeg rreth 33 për qind më pak karburant në një aplikim tipik të ngarkimit të kamionit. Krahasuar edhe

me 336E në të njëjtin aplikim, 336E H djeg 25 për qind më pak karburant. Kjo është e rëndësishme, duke ditur se nuk ka kompromis me rendimentin apo performancën.”

NJË BLERJE E MENÇUR

Klienti i parë për të blerë një 336E H ishte Sten Antonsen, Pronari i SA-Anlegg në Norvegji. Porosia e tij e parë u vendos pikërisht dy ditë pasi u bë njoftimi i shtypit që njoftonte 336E H – megjithëse çmimi akoma nuk ishte vendosur. Duke folur për Per Gunnar Hanssen në Pon Equipment Norvegji, Sten tha, “Konsumi i ulët i karburantit është i rëndësishëm dhe shoqëria ime përpiqet që të jetë e ndërgjegjshme për mjedisin. Le të bëjmë një marrëveshje.” Sten pastaj porositi një 336E H të dytë në Janar 2013.

Kështu, në lidhje me kthimin e investimit, cila është vija fundore? 336E H gjithmonë është një bast i mirë në një mjedis me prodhim të lartë, por një përgjigje precize varet nga çmimet vendore të karburantit dhe sigurisht aplikimi specifik. Sipas Caterpillar, periudha e kthimit mund të jetë deri në dy vjet – edhe më pak në disa rrethana. Sidoqoftë sa më shumë që ju lëvizni, aq më shumë kurseni. Është kaq e thjeshtë.


Paraqitja zyrtare e 336E H në Bauma (Gjermani) në Prill të këtij viti ishte kulmi i programit katër vjeçar të zhvillimit. I disponueshëm tani në Evropë, Japoni dhe në Amerikën Veriore, ekskavatori është në përputhje me shkallën IV të ndërmjetme, faza IIIB dhe synohet veçanërisht për tregje mjaft të rregulluara. ■

Detaje shtesë në: www.uk.cat.com/336EH

Prerja e mbetjeve

në aplikimet e menaxhimit të mbetjeve

Rendimenti në menaxhimin e mbetjeve do të thotë të kontrollosh kostot operative të burimeve njerëzore, të tokës dhe mekanikës. Kjo është e vërtetë për grumbullimin dhe transportin si dhe planifikimin dhe menaxhimin e landfillit.



Nga aftësitë e operatorit, deri tek skemat e mirëmbajtjes dhe efencës së karburantit, makinat Cat® po i ndihmojnë shoqëritë që të realizojnë kursime të mëdha në çdo fushë. Dhe meqenëse ka kaq shumë gjëra për të folur, ne në Revistën Cat vendosëm që të krijojmë disa “studime rasti” të shkurtra që ju tregojnë se si po e bëjnë këtë pajisjet Cat.

Le të fillojmë duke i hedhur një sy kostos totale të posedimit dhe operimit të dy pajisjeve që përdoren shpesh në aplikimet e trajtimit të mbetjeve: Cat 938K, një ngarkues me rrota 16-ton dhe 20.5-ton manipuluesi i materialit M318D.

Çfarë duket menjëherë në të dy shembujt, rreth gjysmë ose më tepër e shpenzimit të posedimit dhe operimit është karburanti. Kështu, konsiderata jonë e parë për menaxhimin e kostos është e qartë. Si të reduktohen kostot e karburantit.



KONSUMIMI I KARBURANTIT

Përparimet në teknologjinë e motorit në 15 vitet e fundit u janë përgjigjur rregulloreve të rrepta të emetimeve EPA dhe atyre Evropiane. Por Caterpillar është fokusuar gjithashtu në reduktimin e madh të konsumit të karburantit nëpërmjet zhvillimeve të mëdha në teknologjinë e transmisionit. Për shembull, në testet standard një Cat D7R me motor Faza IIIa dhe transmision tradicional për ndërrimin e fuqisë që digjet në mesatarisht 37 litra karburant për orë. Me krahasim, një D7E me një motor të Fazës IIIb dhe një transmision elektrik Cat që digjet me më pak se 25 litra në orë është një aplikim i ngjashëm. Me pesë vite me 2,000 orë në vit (duke e marrë çmimin e karburantit me €1.10 për litër), ky është një 33 për qind në konsumim dhe një kursim prej €132,000.



Në një test tjetër që mat eficientën e karburantit në operacionet standarde (magazininim, ngarkesë dhe transport, dhe ngarkim kamionësh), një 966K XE me një motor të Fazës IIIb dhe transmision të fuqisë të avancuar përdorte tre litra më pak karburant në orë (21 për qind) se sa një ngarkues me rrota 966H me një motor të Fazës IIIa dhe transmision të fuqisë. Kjo çon në një kursim prej €33,000 në pesë vjet.



NDIKIMI I OPERATORIT

Ashtu si një motorist me aftësi mund të udhëtojë me më pak karburant se sa një shofer mesatar, aftësitë e një operatori makine kanë një ndikim të madh në konsumin e karburantit në kostot e operimit të një fabrike të trajtimit të mbetjeve.

Kjo është arsyeja përse tregtarët e Caterpillar dhe Cat zhvilluan programin e Trajnimit të Operatorëve Eco, për shembull. Qëllimi është të "përshtaten" operatorët me makinën ekzakte që përdorin. Si rezultat tu jepen atyre aftësi për të optimizuar konsumin e karburantit ndërkohë që plotësojnë kërkesat e prodhimit, përmirësojnë operimin dhe sigurojnë përdorimin më të mirë të aftësive të pajisjes, gjë që ndihmon gjithashtu që makina të ketë sa më shumë kohë pune.

Përveç kësaj, menaxherët e flotës mund të monitorojnë dhe të rishikojnë nga larg performancën e makinës dhe operatorit. Në këtë mënyrë, nevoja për trajnimin e operatorëve mund të identifikohen dhe mund të jepet pajisja e duhur për të optimizuar konsumin e karburantit dhe përdorimin e pajisjes. Caterpillar i pajis makinat me sistemin Product Link™ një sistem telemetrik nga larg që mbledh të dhënat e makinës të tilla si konsumi i karburantit, përdorimi i makinës dhe gjendjen e komponentëve. Të dhënat pastaj dërgohen nëpërmjet satelitit ose GSM menaxherëve të flotës të cilët me anë të VisionLink® mund të marrin vendime në kohë, me efektivitet kostoje që të kenë një efekt pozitiv në shpenzimet tuaja fundore.

MAKINA E DUHUR PËR APLIKIMIN E DUHUR

Për këtë shembull, një makinë ngarkon kamionët që janë 4 metra të lartë, 2.55 metra të gjerë dhe 12.5 metra të gjatë. Në rreth 0.2 kg për metër kub, densiteti i materialit nuk është problem. Qëllimi, megjithatë, është vëllimi maksimal për kamionë për të reduktuar kostot e transportit. Atëherë, është ky ndërtim optimal? Ja tre opsione.

Opsioni A) Manipulues

Materiali 20.5-ton

E shumanshme për të punuar në lartësi të ndryshme, një makinë si M318D MH është shumë efiçente për karburantin në shumë aplikime. Megjithatë kapsja nuk është ideale për një prodhim ngarkues të madh



Opsioni B) Ngarkuesi me Rrota 20-ton

Një ngarkues i madh me rrota me një krah të lartë ngritës, nevojitet për të arritur lartësi prej katër metra me lartësinë e mjaftueshme për të optimizuar kapacitetin. Ky ka kapacitet më të mirë ngarkues se sa një ekskavator ose manipulues materiali dhe është më i përshtatshëm për ngarkimin e prodhimit



Opsioni C) Ngarkuesi me Rrota 16-ton

Në këtë rast, zgjidhja më e mirë është që të përdoret një sipërfaqe e ngarkuesve për të ulur lartësinë e madhe të ngarkimit. Kjo e bën një makinë më të vogël me një mjet ngarkues me të njëjtën madhësi më efiçente. Ka një kosto të vogël të hyrjes, kohët e përmirësuar të ciklit dhe më pak konsum karburanti. Kursimet e karburantit mund të shkojnë deri në €2.42 për kamion, krahasuar me zgjidhjen e manipuluesit të materialit.



ZGJEDHJA E GOMAVE

Materialet e menaxhimit të mbetjeve nuk janë miqësore për gomat. Por cilat goma janë ato që ju duhen ju?

Gomat pneumatike janë të mira për cikle udhëtimi më të gjata. Ato ofrojnë trajtim dhe komfort për operatorin por mund të çahen ose shpohen, gjë që rrit kohën pa punë plus kostot e mirëmbajtjes dhe riparimit. Gomat pneumatike të mbushura me shumë e ulin potencialin për shpim, por reduktojnë manipulimin dhe komfortin për operatorin. Plus, ato mund të kushtojnë rreth €1,000 më shumë për gomë.

Gomat e forta, megjithëse më të kushtueshme fillimisht, shpesh janë zgjedhja optimale. Në të kaluarën, gomat pneumatike të forta e bënin ngarjen e makinës më të vështirë për operatorët dhe më të ashpër për shasinë dhe akset e makinës.

Gomat Cat Flexport™ janë një zgjidhje e shkëlqyer. Këto goma të forta janë inxhinieruar me vrima për fleksibilitet dhe amortizim për një ngarje dhe stabilitet më të mirë. Pas më shumë se 10,000 orësh operimi, një analizë e kostosh për orë tregoi një kursim prej



€2.92 për orë krahasuar me gomat pneumatike të mbushura me shumë për detyra të rënda L5 dhe një kursim prej €5.92 mbi gomat për detyra të rënda pneumatike L5. Pra është një kursim prej €29,200 dhe €59,400, përkatësisht.

Gomat Flexport gjithashtu garantojnë qëndrueshmëri më të madhe dhe mund të kenë një kohëzgjatje prej 6,000 deri në 9,000 orë – rreth dy deri në tre herë më të gjatë se sa gomat standarde për detyra të rënda apo radiale në aplikimin e mbetjeve.

FILTRIMI I KABINËS

Gjërat e këqija që janë në tokë, që janë në ajër mund të jenë po aq të rrezikshme. Pluhuri i ajrit dhe pislëku e bëjnë të rëndësishëm ngjeshjen dhe filtrimin e ajrit në kabinë. Mund të krahasojmë efektivitetin – dhe impaktin në kostot operative – të dy zgjidhjeve popullore.



Sistemet standarde PFP (Parapastruesit + Filtruesit + Ngjeshësit) normalisht mbështeten në ajrin që kalon përmes shtresave të shumëfishta të filtrave për të larguar lëndën e grimcave. Sistemi ciklonik parapastrues në pajisjet Cat, megjithatë, përdor rrjedhën centrifugale të ajrit për të nxjerrë 90 deri në 95 për qind të pjesëzave të ajrit edhe para se ato të arrijnë në fazën e filtrimit. Vetëm një filtër kërkohet aty ky më parë nevojiteshin tre. Plus, jeta e dobishme e atij filtri është më e gjatë.

Një analizë e bërë për 10,000 orë (ose rreth pesë vjet të botës reale të operimit), tregoi se përdorimi i sistemit Cat të filtrimit paraciklonik të kabinës kurseu rreth €18,000 krahasuar me një sistem filtrimi PFP të zakonshëm.

SHPENZIMET

Aplikimet e menaxhimit të mbetjeve janë të ndryshme krahasuar me çdo fushë tjetër të pajisjeve të rënda. Çdo operim i menaxhimit të mbetjeve ka sfidat e veta unike.

Nuk mund të ketë një zgjidhje të vetme, standarde “më produktive” ose “më ekonomike”. Maksimumi i efikasitetit operative është produkti i zgjedhjeve të pajisjes me kantierin dhe kërkesat e prodhimit.

Ndërsa kostoja fillestare ka rëndësi, ajo është një pjesë e vogël e të gjithë kostos së punësimit dhe operimit gjatë jetës së një pajisjeje. Prandaj, Caterpillar ka burimet dhe ekspertët që ndihmojnë për ta bërë analizën e pamjes së madhe, rast pas rasti, përgjatë spektrit të aplikimeve të menaxhimit të mbetjeve.

Në varësi të operacionit tuaj, përdorimi i pajisjes së duhur për çdo aplikim, duke garantuar trajnimin e operatorit dhe fokusimin në bashkëlidhjen e duhur me më pak karburant dhe kostot operuese të përgjithshme si dhe çmimin e blerjes së makinës. ■

Mësoni më tepër në: www.cat.com/waste/products-and-applications



FOKUSI

Qendra e Vizitorëve të Caterpillar

Nëse keni dashur ndonjëherë të operoni një buldozer dhe ekskavator Cat® ose të qëndroni pranë gomës më të madhe në botë (4.028 metra e lartë nga Cat 797), filloni planifikoni udhëtimin tuaj për në Qendrën e Vizitorëve Caterpillar.

Qendra u hap në Tetor 2012 dhe ndodhet në vendin historik Riverfront në Peoria, SHBA – ku ka zyrat kryesore Caterpillar. Ata që e vizitojnë fasilitetin ndër-aktiv mund të shikojnë të kaluarën, të tashmen, të ardhmen dhe të bëjnë mirë çdo gjë midis tyre. Për shembull, vizitorët:

- Mund të bëjnë një ngjarje virtuale në minierë në shtratin e një kamioni masiv Cat 797F
- Mund të operojnë një makinë Cat duke përdorur simuluesit modernë
- Mund të projektojnë makinat e tyre Cat dhe t'i dërgojnë me e-mail projektet e tyre
- Mund të ngjiten mbi një traktor antik D8 të vitit 1930
- Mund të shikojnë se si i projekton dhe i ndërton makinat motorët dhe fabrikat Caterpillar, duke përdorur teknologjinë 3D
- Mund të shikojnë Caterpillar Nr. 31 NASCAR



Fasiliteti i ri është një shikim intrigues brenda botës së Caterpillar. Nga traktori i parë i shoqërisë deri tek i fundit, makinat e teknologjisë së lartë nëse dëshironi të shikoni se si një nga prodhuesit më të rëndësishëm të pajisjeve në botë arrijnë ta bëjnë të mundur progresin e qëndrueshëm (ose në qoftë se thjesht jeni një admirues i Caterpillar), ky është vendi për ju. Bëhuni gati për argëtim dhe emocion në detyra të mëdha. ▲

Fillojeni përvojën tuaj dhe mësoni më tepër në: www.caterpillar.com/visitors-center

Shtysat e sigurisë çojnë drejt makinave autonome



Mbajtja e operatorëve të sigurt është prioriteti numër një. Kjo është arsyeja përse Caterpillar po zhvillon makina që mund të operohen nga larg ose në mënyrë autonome.

Elementët që bëjnë të mundur operimin autonom përfshijnë:

- **Perceptimi:** sensorët e tillë si LIDAR, radar dhe kamerat HD kombinohen dhe përpunohen në mënyrë që të makinat të mund "të shikojnë" mjedisin e tyre
- **Pozicionimi:** njohja se ku është dhe si është e orientuar makina
- **Navigimi dhe rrjedha e punës:** inteligjenca në bord, shpesh e kombinuar me

Software Office, i japin sinjale makinës se si të navigojë në kantier dhe çfarë pune duhet të plotësojë, duke përfshirë detyrat e transportit, ekzekutimin e manteleve të shpimeve dhe planeve të gjermimit.

Tre shembuj të projekteve autonome ose gjysëm autonome aktuale të operacioneve të Caterpillar janë:

- Zhvillimi i Infrastrukturrës Planetare me Administratën e Aeronautikës Kombëtare dhe Hapësirës (NASA). Qëllimi është të zhvillohet një tele-operacion (operacion nga larg Tokës) dhe një kontroll gjysëm autonom i thikës në pajisjen Cat. Një aplikim mund të ishin misionet planetare eksploruese dhe ndërtimi. Caterpillar dhe NASA kanë punuar së bashku për tre vite mbi këtë projekt.

- Në Australinë Perëndimore, Caterpillar dhe Tregtari Cat WesTrac janë në procesin e dislokimit të 12 kamionëve autonomë në Minierën e Grupit Solomon të Metaleve Fortescue me plane për të zgjeruar flotën në një kohë të afërt.

- Caterpillar dhe WesTrac po punojnë gjithashtu me BHP Billiton për të lançuar një Komandë Cat për të provuar transportin e prodhimit në kantierin Jimblebar në Australinë Perëndimore më vonë gjatë këtij viti.

Qëllimi i autonomisë është që të rrisë burimet ekzistuese për të plotësuar kërkesat gjithnjë e më të shpejta të burimeve globale dhe për t'i mbajtur njerëzit jashtë mjediseve potencialisht të rrezikshme. ▼

Mësoni më tepër në:
www.mining.cat.com/command.



Një risk i madh për mbështetjen e klientit është mungesa e teknikëve të cilët mund të mirëmbajnë dhe t'i kryejnë servis makinave Cat®. Duke e kuptuar këtë fakt, Barloworld Equipment në Afrikën e Jugut, u bë tregtari i parë në Afrikë që mori pjesë në programin Caterpillar ThinkBIG [mendo gjerësisht].

Ideja e programit ishte që të sigurojë që gjithmonë të ketë teknikë servisi me aftësi të mëdha për të plotësuar tregun në rritje dhe kërkesat e klientëve. "Meqenëse për shkak të zhvillimeve të teknologjisë, na nevojiten njerëz me aftësi analitike reale për defektet," thotë Tienie Viljoen, Menaxheri i Performancës Operativë të Barloworld Equipment - Service LoB.

Partneriteti me Universitetin e Johannesburgut, bëri që programi ThinkBIG i Barloworld Equipment's të fillonte më 21 Shkurt 2013. Ky program intensiv tre-vjeçar i nivelit universitar kombinon punën në klasë me mësimin në praktikë në terren dhe në laboratorët modernë. Ai u jep studentëve arsimin praktik dhe teknik që nevojitet për tu bërë ekspertët teknikë. Fokusi është në servilin ndaj pajisjeve Cat duke përdorur diagnostikimin e fundit, sistemet e mirëmbajtjes, teknologjitë e avancuara dhe mjetet e teknologjisë së lartë të kohëve të fundit.

"Kur të diplomohen studentët tanë, ata do të marrin Diplomën Kombëtare për Teknologjinë e Inxhinierimit Mekanik," shtoi Tienie. "Në secilin prej dy viteve të ardhshëm, ne shpresojmë që ta dyfishojmë numrin e studentëve që marrin pjesë."

Barloworld Equipment ka një qendër trajnimi dhe rreth 600-metër katrorë oficinë (që funksionon me dy turne) me 12 ndarje që mund të akomodojnë 144 studentë. Ka gjithashtu 12 dhoma leksionesh dhe 120 rezidenca për studentët.



Dominic Sewela, Administrator, Barloworld Equipment Afrika e Jugut (në të majtë), dhe Prof. Tshilidzi Marwala, Dekan Ekzekutiv, Fakulteti i Inxhinierisë në Universitetin e Johannesburgut nënshkruajnë një memorandum mirëkuptimi.

Programi ThinkBIG tani u ofrohet 20 kolegjeve dhe universiteteve në të gjithë botën dhe programi mburret me afërsisht 100 për qind vende pune të të diplomuarve të suksesshëm. Që prej fillimit të tij në vitin 1997, ThinkBIG ka arsimuar më tepër se 3,100 studentë. ■

Mësoni më tepër: www.caterpillar.com/careers/americas/dealer-technician/thinkbig-technician-education

THINKBIG
NDIHMON BARLOWORLD TË MENDOJË
PËR NJË AFAT TË GJATË



KLIENTËT E CATERPILLA SHPREHIN MENDIMET E T CAT® 740B DHE NXJERRËS 740B



R
TYRE

Në industrinë e lëvizjes së dheut, rendimenti ka rëndësi. Dhe të marrësh prodhimin që kërkon, më mirë se sa me kamionët e artikuluar të Cat® 740B dhe Nxjerrësi 740B. Të dy ofrojnë besueshmëri të provuar dhe qëndrueshmëri dhe janë projektuar për të përmirësuar kohët e ciklit, sigurinë dhe komfortin e operatorit. Në fakt, 740B 39.5-ton dhe Nxjerrësi 740B dhe 38-ton konsiderohen standard i industrisë.



KONTROLLI I VËRTETË I TËRHEQJES AUTOMATIKE

Sistemi i kontrollit të tërheqjes së kamionëve është në përpjesëtim të plotë me katër diferencialët me friksion me shumë disqe. Gjashtë sensorë monitorojnë rrëshqitjen e rrotës në çdo rrotë. Dhe sistemi menjëherë dhe automatikisht (ndërsa është në lëvizje) përzgjedh kombinimin më të mirë të kyçjes së diferencialit për të maksimizuar tërheqjen. Kjo do të thotë:

- nuk ka butona ose çelësa
- oratorët pa përvojë janë më produktivë
- lodhje e reduktuar e operatorit
- dëm i reduktuar në linjën e shtytjes

SISTEMI I SHTYTJES EFIÇENT, I QËNDRUESHËM

Sistemi me shtatë shpejtësi i kontrolluar në mënyrë elektronike është ndërtuar që të

“Pesë 740B që kemi na ndihmojnë të transportojmë gjysëm milionë metër kub çakull.”

Erik Spilling, Inxhinier Civil dhe Menaxher i Projektit me TT Anlegg

ketë jetëgjatësi. Përveç qëndrueshmërisë udhëheqëse në industri, transmisioni i Serisë B ka strategjinë e kontrollit APECS, i cili përfshin ndërrimin e valvolës së pjesshme dhe menaxhimin e ndërrimit të dredhjes. Këto tipare përmirësojnë mjaft performancën e makinës krahasuar me modelet e mëparshme. Sistemi i shtytjes së Serisë B:

- siguron një rritje prej 5 për qind të fuqisë dhe 4 dredhje
- rrit produktivitetin dhe redukton konsumin e karburantit
- përmirëson komfortin e operatorit nëpërmjet ndërrimit më të butë

STIL I RI, SIGURI SHITESË

Tiparet e përmirësuar të sigurisë përfshijnë drita kryesore më të gjera dhe sinjale për të rritur ndriçimin dhe vizibilitetin. Qëndrueshmëria e pjesës para në fund gjithashtu është përmirësuar me projektimin e një paracolpi të vetëm. Tiparet e tjera të jashtme përfshijnë:

- mbrojtëse të plotë të mbyllur të barkut
- platformë udhëheqëse të industrisë dhe të mbajtësve anësore

Sigurisht dallimi kryesor midis 740B dhe Nxjerrësit 740B është tipari i nxjerrjes. Idealist i përshtatur për të mbartur materiale të lagështa dhe ngjitëse, Nxjerrësi rrit stabilitetin dhe sigurinë duke e shtyrë ngarkesën me një thikë çeliku me fuqi të lartë në vend të ngritjes së karrocërisë së shkarkimit. Përfitime të tjera kyçe të sistemit të Nxjerrësit janë:

- e shpërndan më lehtë materialin duke reduktuar nevojën për pajisje mbështetëse
- mund ta nxjerrë materialin gjatë ecjes për të reduktuar shumë kohët e ciklit
- virtualisht eliminon mbetjet e ngarkesës dhe rrit produktivitetin



MENDIME TË KLIENTIT

Ne folëm me dy klientët një që operon në Norvegji dhe një tjetër në Gjermani dhe u kërkua atyre opinionet e tyre për Cat 740B dhe 740B Ejector.



ERIK SPILLING PËR 740B

Duke përdorur një 740B, TT Anlegg specializohet në ndërtimin e rrugëve, projektet e hidrocentraleve dhe kantierëve industriale. Shoqëria aktualisht është duke përmirësuar digën e hidrocentralit Svartevatn— më e larta në Norvegji.

Pyetje: Si përdoren makineritë Cat 740B që keni?

ERIK SPILLING: “Pesë 740B që kemi ndihmojnë transportin e një gjysëm milionë metri kub çakulli. Kamionët punojnë 70-orë në javë duke lëvizur rreth 300 metër kub çakull në orë.”

Pyetje: Si ndihmon 740B?

ERIK SPILLING: “Ka shumë përfitime. Një nga më të rëndësishmet është se ato na ndihmojnë të lëvizim shumë material në një kohë të shkurtër kohe.”

Pyetje: A ndihmon kontrolli i tërheqjes?

ERIK SPILLING: “Diferenciali automatik dhe kontrolli i tërheqjes janë shumë të rëndësishme. Në kushtet me borë dhe me akull është shumë më mirë që të kesh një kamion të artikuluar me kontroll tërheqjeje. Ne transportojmë materialet përgjatë një rrugë të thepisur prej një kilometri. Por këto kamion të Cat nuk kanë probleme. Ky sistem i ri Cat na ndihmon gjithashtu që të parandalojmë konsumin e gomave në mënyrë që ta bëjmë punën në mënyrë efçente dhe të sigurt dhe të kontrollojmë kostot.”

Pyetje: A e trajtoni mirëmbajtjen dhe servilin në këtë vend kaq të largët?

ERIK SPILLING: “Kemi një marrëdhënie shumë të mirë me Pon Norway. Ata na i rregullojnë problemet shpejt dhe janë gjithmonë ndihmues, veçanërisht për

servisin dhe mirëmbajtjen. Kemi një kontratë servisi për makinat më të reja por kujdesemi edhe për makinat më të vjetra vetë. Me makinat Cat, ne e dimë se çfarë marrim. Këto makina janë vlerë e mirë për parane.”

FRIEDRICH KÖNEN, ADMINISTRATOR I ADOLF SCHUMACHER PËR NXJERRËSIN 740B

Nxjerrësi 740B po përdoret nga RWE Power, një shoqëri komunale Gjermane e bazuar në Essen, North Rhine-Westphalia që furnizon me energji elektrike 20 milionë klientë dhe me gaz 10 milionë klientë.

Pyetje: Çfarë detyrash kryen në terren makineria Cat 740B Ejector?

FRIEDRICH KÖNEN: “Ne kemi pesë kamionë Ejector këtu. Ato përdoren kryesisht për të transportuar argjilën.”

Pyetje: Si ndihmon tipari i nxjerrjes?

FRIEDRICH KÖNEN: “Peizazhi këtu është i pjerrët. Shkarkimi duke e kthyer kazanin do të ishte i pamundur. Nxjerrësi na lejon ne që të kontrollojmë shkarkimin pa e ngritur kazanin dhe kjo është më e sigurt.”

Pyetje: A ka qenë kontrolli i tërheqjes automatike një faktor vendimtar në zgjedhjen e 740B Ejector?

FRIEDRICH KÖNEN: “Në kohë të keqe këtu nuk ka tokë të qëndrueshme. Kushtet me shpejtësi ndryshojnë dhe disa zona janë pothuajse të pakalueshme. Falë sistemit të tyre me shtytje të të gjitha rrotave dhe karrocërisë së artikuluar, 740B Ejector janë idealë.” ■

Mësoni më tepër në: www.uk.cat.com/equipment/articulated-trucks

▲◀ (Nga e djathta në të majtë) Adolf Schumacher Administrator, Friedrich Könen; Drejtor Tregtar, Frank Könen; Drejtor i Shitjeve të Zeppelin, Kay-Achim Ziemann; Gerald Jaschinsky Mbikëqyrës, Adolf Schumacher; Menaxher i Degës Zeppelin, Stefan Lanio; Oficer i Teknologjisë Caterpillar, Martin Haber Berger.

▲▲ Materialet e lagështa, të rënda transportohen në kantierin Inden, Gjermani, ku përqindja mesatare e pjerrësisë është 1:3.

▲ Një karrocëri e projektuar në mënyrë të veçantë përdor një thikë çeliku me fuqi hidraulike për shkarkimin e kontrolluar të materialit.

KURSENI KOHËN ME ÇDO NDRYSHIM VEGLASH



E RE AUTO-LIDHJA

Lidhësi i Shpejtë, automatik
i plotë

NË ÇDO KOHË LIDHJE TË SHPEJTA, TË SIGURTA NGA DEFEKTI

Performancë më e mirë. Eficiencë më e madhe. Besueshmëri absolute. Tani ju mund të kryeni ndryshimet e veglave në sekondë! Xhuntoja hidraulike për Auto-Lidhje e re e Caterpillar e automatizon plotësisht shkëmbimin e veglave, kështu që operatorët mund t'i ndryshojnë veglat e punës me shpejtësi, nga siguria dhe komforti i kabinave të tyre. Kjo është mënyra më e shpejtë, më efiçente, për të ndërruar veglat kur je duke punuar. E ndërtuar në terren - platforma e provuar CW e xhuntos së shpejtë, projektimi unik i Auto-Lidhjes siguron lidhje të sigurta nga dështimi në çdo kohë - duke eliminuar derdhjet e vajit. Ajo parandalon gjithashtu linjat e prishura hidraulike duke shmangur kohën pa punë të paplanifikuar. I bëni operatorët tuaj më eficientë dhe produktivë. Gjithë ditën. Çdo ditë. Merrni lidhjen e Caterpillar.

Të gjitha nevojat e veglave të punës, kontaktoni Tregtarin tuaj vendor Cat® Shpërndarës



©2012 Caterpillar Inc. Të gjitha të drejtat e rezervuara. CAT, CATERPILLAR, logot e tyre përkatëse, "Caterpillar e Verdhë" dhe rrobat e punës POWER EDGE si dhe identiteti i shoqërisë dhe produkti i përdorur këtu janë marka tregtare të Caterpillar dhe nuk mund të përdoren pa leje AEXQ0705-00



Teknoxgroup





©2011 Caterpillar, All Rights Reserved. CAT, CATERPILLAR, their respective logos, "Caterpillar Yellow" and the POWER EDGE trade dress, as well as corporate and product identity used herein, are trademarks of Caterpillar and may not be used without permission.



TEKNOXGROUP KOSOVO L.L.C.
Llapnaselle, Prishtine, Kosove
Magjistrali Shkup - Prishtine
Mobil: +377 4 45 02 842

